



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

## **Takim reflektiv me përfituesit/et e programit të Klinikës Kushtetuese dhe Administrative dhe punës praktike nëpër administrata komunale**

YIHR KS në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ka mbajtur takim me studentët/et e kursit semestral jashtë-kurrikular "Klinika Kushtetuese dhe Administrative". Takimi është hapur me një fjalim rasti nga Prodekanja për Projekte të Studentëve, Prof. Dr. Luljeta Plakolli-Kasumi, Koordinatori i Zyrës për Mësim Klinik, Prof. Dr. Muhamet Vokri dhe Drejtorja Ekzekutive e YIHR KS, Marigona Shabiu.

Gjatë takimit, studentët/et përfitues/e të programit të Klinikës dhe praktikës ndanë me ekipin e projektit përvojat e tyre si gjatë ligjëratave të kursit dhe patjetër mësimet e marra nga angazhimi i tyre në punë praktike të sponsorizuar nga YIHR KS me mbështetje të Departamentit Amerikan të Shtetit (INL).

Studentët të cilët/cilat kanë përfituar nga ky program i praktikës kanë qenë të angazhuar në komunën e Prizrenit, Pejës, Shtimës, Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajit. Ndërsa studentët të cilët kanë kërkuar të angazhohen në komunën e Prishtinës nuk kanë marr ndonjë përgjigje nga komuna, me ç'rastë këta studentë janë angazhuar në zyre të avokaturës për ta përfunduar programin e praktikës.

Ndër çështjet kryesore që u ngritën gjatë këtij takimi ishin rreth: qasjes së dretësisë në nivelin komunal; trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve nga niveli komunal; transparenca e nivelit komunal; përfshirja e qytetarëve/eve në politikat komunale; trajtimi i grupeve të marginalizuara nga niveli komunal; a kanë/ dhe cilat janë politikat e komunave për integrimin e grupeve të marginalizuara në politikat komunale.

Gjatë takimit, shqetësimet kryesore të cilat janë ngritur nga grupi i studentëve është që niveli komunal ballafaqohet me mungesë të theksuar të stafit. Ndërkaq mungesa e stafit shkakton pengesa të shumta për shqyrtimin në kohë të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve. Gjatë punës praktike në komuna, disa studentë kanë treguar që për shkak të mungesës së stafit në nivelin komunal, ata janë obliguar të marrin përsipër punë administrative pa pasur ndonjë mbikëqyrje. Për më tepër, shumë drejtori komunale kanë mungesë të juristëve, gjë që e bënë të vështirë për administratën komunale të adresojë problemet e qytetarëve.

Edhe pse shumica e studentëve që morën pjesë në takim shprehën kënaqësitë e tyre në raport me transparençën komunale; ata/ato theksuan që ka shumë raste kur qytetarët nuk informohen në kohë për thirrje të caktuara komunale. Ndërsa një problem tjetër që paraqitet në nivelin komunal është që në shumicën e rasteve nuk janë të caktuara afatet kohore se kur do të marrin përgjigje për vendimet që lidhen me ankesat dhe kërkesat e qytetarëve. Për më tepër studentët theksuan që qytetarët ende vazhdojnë të presin në rradhët e gjata për të marr dokumente të caktuara nga komuna prandaj edhe është e nevojshme digjitalizimi i shërbimeve komunale.

## **Rekomandimet:**

**Hapja e të dhënave (Open Data)** – Studentët rekomanduan që të bëhet hapja e të dhënave për publikun, kështu duke mundësuar trajtim më të lehtë të kërkesave të drejtuara ndaj nivelit komunal. Kjo do të ndikonte edhe në uljen e volumit të punës së zyreve për informim, duke trajtuar më pak kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare.

**Digjitalizimi i shërbimeve** – Digjitalizimi i shërbimeve do të eliminojë barrën e administratës komunale dhe pritjen e qytetarëve në radhët e gjata për të marr dokumente të caktuara nga komuna.

**Krijimi i mekanizmit përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve** – Të krijohet mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve, por gjithashtu edhe informimin sa më të mirë të qytetarëve rreth statusit të kërkesave dhe ankesave të tyre.

